

Kontrata e integritit republikan



Zonjë, Zotëri,

Sot, ju jeni tek Zyra franceze e imigrimit dhe e integritit (OFII) për të firmosur kontratën tuaj të integritit të Republikës (CIR).

Në këtë mënyrë, ju shprehni dëshirën për tu vendosur në mënyrë të përhershme në Francë, shteti juaj i pritjes, dhe të angazhoheni në një kurs të personalizuar integriti.

Përmes kësaj kontrate, ju do të keni të drejta por gjithashtu duhet të respektoni rregulla dhe ti nënshtroheni detyrimeve.

☞ **Angazhimi në rrugën e personalizuar të integritit të Republikës**

Takimi personal i sotçëm ka si piksynim të vlerësojë nevojat tuaja, tju japi formacione dhe tju drejtojë sipas situatës tuaj individuale.

• Formacioni qytetar

Kursi juaj fillon me formacionin qytetar të deryrushëm, që zgjat 2 ditë.

• Formacioni gjuhës

Nëse niveli juaj i gjuhës është nën nivelin A1 të kriterit evropjan të përgjithshëm të referencës për gjuhët (CECRL), duhet të ndiqni një kurs gjuhe për tu përmirsuar drejt këtij niveli. Në këtë mënyrë ju do të keni njohuri të gjuhës franceze të cilat do tju lejojnë të komunikoni në jetën e përditshme.

• Informacione

Në të njejtën kohë, mund të kërkonti të dhëna mbi të drejtat tuaja dhe mbi shërbimet publike për të cilat mund të keni nevojë (shkollat, spitalet, sigurimi shëndetësor,...).

☞ **Respekti i CIR-it, një kusht për lëshimin e lejes tuaj të qëndrimit shumëvjeçar**

Duke firmosur CIR-in, ju angazhoheni të jeni prezent dhe serioz në formacionin qytetar dhe kursin e gjuhës që ju janë çaktuar.

Gjithashtu ju duhet të respektoni vlerat themelore të shoqërisë franceze dhe të Republikës.

Në qoftë se respektoni këto kushte, mund tju jepet një leje qëndrimi shumëvjeçare.

☞ **Vazhdimi i rrugës dhe lëshimi i kartës të qëndrimit**

Mund të vazhdoni kursin tuaj të personalizuar të integritit republikan me mësimet më të thella të gjuhës franceze.

Nëse dëshironi të merrni kartën e qëndrimit, duhet të keni arritur nivelin e gjuhës A2 të CECRL.

Gjithashtu, duhet të rrespektoni në mënyrë efektive parimet që përbëjnë Republikën franceze.

Nëse respektoni në këtë mënyrë kushtet e integritit të Republikës, mund tju jepet një kartë qëndrimi.

Neni 1 i Kushtetutës Franceze i datës 4 tetor 1958 : « Franca është një Republikë e pandarë, laike, demokratike dhe sociale. Ajo siguron barazinë përpara ligjit, të të gjithë qytetarëve pa dallim origjine, race apo feje. Ajo rrespekton të gjitha fetë. Organizimi i saj është i çqëndruar. Ligji favorizon në mënyrë të barabartë votën për gratë dhe për burrat në mandatet e zgjedhjeve dhe në fushën e zgjedhjeve, gjithashtu dhe në përgjegjësitë profesionale dhe sociale. »

Kontrata e integritit republikan

Kontrata e integritit të Republikës

Kontrata e integritit të Republikës, përcaktuar nga neni L. 311-9 i kodit të hyrjes dhe qëndrimit të të huajve dhe të drejtës të azilit, është lidhur mes jush dhe Shtetit Francez, përfaqësuar nga prefekti. Ajo bazohet në angazhimet reciproke.

I. Angazhimet e Shtetit

Shteti organizon një pritje për të favorizuar integritin tuaj. Ai përfshim shërbimet në vijim :

- takim personal me një përfaqësues të OFII-t që lejon të vlerësojë nevojat tuaja, tju japi formacione dhe tju drejtojë sipas situatës tuaj individuale ;
- një formacion qytetar i përbërë nga dy tema :
Parimet dhe vlerat e Republikës Franceze ;
Të jetosh dhe të gjesh punë në France ;
- Një test gjuhe i bërë nga OFII për të parë nivelin tuaj në gjuhën frënge ;
- nëse është e nevojshme një kurs frengjishte për të cilin nevojat dhe kohë zgjatja përcaktohen sipas nivelit të gjuhës A1 të CECRL.

II. Detyrimet tuaja

Ju angazhoheni që :

- të respektoni vlerat themelore të shoqërisë franceze dhe të Republikës ;
- të merrni pjesë rregullisht dhe seriozisht në formacionet qytetare dhe në kursin e gjuhës ;
- të bëni përçapjet që ju ka caktuar OFII gjatë takimit ;
- të lajmëroni OFII-n me postë për çdo ndryshim situatë.

III. Afati i kontratës

CIR-i është firmosur për një afat një-vjeçar, veçanërisht ai mund të zgjatet nga prefekti, për arsye të ligjshme, brënda kufirit të një viti tjetër. CIR-i mund gjithashtu të ndërpritet nga prefekti me propozimin e OFII-t nëse nuk respektoni kushtet e prezencës dhe seriozitetit dhe nëse keni treguar një refuzim të vlerave themelore të shoqërisë franceze dhe të Republikës.

Drejtimi i personalizuar

Mbas takimit të bërë sot, do ju jepen formacionet në vijim :

- **Formacion qytetar « Parimet dhe vlerat e Republikës franceze »**
 I detyrueshëm
- **Formacioni qytetar «Të jetosh dhe të gjesh punë në France»**
 I detyrueshëm
- **Formacioni gjuhës**
 Niveli A1 i arritur (nuk nevojitet formacioni i gjuhës)
 Niveli A1 i pa arritur (caktimi i orëve në një kurs gjuhe)

Për më tepër, jeni drejtuar drejt ofertës të shërbimeve në vijim:

CIR-i është faza e parë e rrugës suaj të integritit në France. Duhet të respektoni të drejtat dhe detyrimet. Kjo është garancia e integritit të suksesshëm në vendin tuaj pritës

Kontrata e integritit të Republikës n°

Lidhur më

Mes Z./Znj (për minorenët, përfaqësuesi ligjor) :

n° AGDREF :

Firma :

Dhe prefekti i departamentit :

Në rast zgjatje të kontratës (afati, data e fundit, arsyeja):